



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

Nr. Prot.

Vlorë, më 06.10.2016

Vendim
Nr. 39, datë 06.10.2016

PËR PËRCAKTIMIN E KATEGORIVE TË PERSONELIT
NDIHMËSAKADEMIK ME KARAKTER MËSIMOR DHE
PERSONELIT NDIHMËSAKADEMIK ME KARAKTER ADMINISTRATIV

Në mbështetje të nenit 66 të ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", "Personeli ndihmësakademik", në funksion të hartimit të Strukturës së Përgjithshme të Institucionit dhe numrit të personelit të Institucionit në të gjitha nivelet, Senati Akademik në mbledhjen e datës 06.10.2016

VENDOSI:

1. Në kategorinë e *personelit ndihmësakademik* me karakter mësimor, përveç laborantëve dhe teknikëve, përcaktuar në ligj (neni 66, pika 2) të përfshihen edhe punonjësit e pozicioneve që ofrojnë shërbime në bazat logjistike të UV-së që mirëmbajnë, pastrojnë, rikuperojnë, modifikojnë aparatura laboratorësh të departamenteve/qendrave kërkimore-shkencore, veprimtaria e të cilëve ndihmon në realizimin dhe mbështetjen e procesit mësimor dhe kërkimit shkencor.
2. Në kategorinë e *personelit ndihmësakademik* me karakter administrativ të përfshihen:
 - a) **Në nivel njësie bazë:** punonjësit e sekretarive të cilët krijojnë, ruajnë, administrojnë dhe shërbejnë dokumentacionin e procesit mësimor sipas nenit 101 të ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë".
 - b) **Në nivel njësie kryesore:** punonjësit e kryesekretarive të cilët krijojnë, ruajnë, administrojnë dhe shërbejnë dokumentacionin e procesit mësimor sipas nenit 101 të ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë",



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

sekretarët e Dekanëve, punonjësit ndihmës të departamenteve apo të qendrave kërkimore shkencore dhe çdo pozicion pune tjetër që vepron brenda fushës së përshkruar në nenin 66, pika 3 e ligjit të referuar.

- c) **Në nivel institucional:** punonjësit të cilët ndihmojnë në realizimin dhe mbështetjen e veprimtarive të mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe zhvillimit të institucionit.

Në këtë kuptim, kategoria e personelit ndihmësakademik me karakter administrativ të përfaqësohet me pozicionet e punës që lidhen me:

1. Jetësimin e politikave dhe strategjive akademike dhe administrative të UV-së si dhe amplifikimin e tyre në rrafsh kombëtar, rajonal e ndërkombëtar, përmes informimit, komunikimit, marrëdhëniet me publikun, promocionin dhe marketingun akademik e universitar.
2. Shërbimet/këshillimet akademike ndaj studentëve dhe pedagogëve.
3. Këshillimet dhe shërbimet e brendshme dhe të jashtme mbështetëse dhe zhvillimore të institucionit.
4. Programet e studimit.
5. Kërkimin shkencor bazë dhe të aplikuar.
6. Marrëdhëniet me IAL-të brenda e jashtë vendit, MAS-in dhe agjencitë e ndryshme qeveritare ose jo të tilla.
7. Projektet me BE-në dhe të tjerë.
8. Shërbimet e IT-së dhe statistikat.
9. Veprimtarinë juridike, (përfaqësimi institucional, ligjshmëria akademike, mbrojtja e studentëve etj.).
10. Vlerësimin e jashtëm dhe të brendshëm të veprimtarisë së institucionit.
11. Karrierën akademike të personelit akademik.
12. Burimet njerëzore, shërbimet e librit shtypshkronjë dhe E-book.
13. Sekretarinë e Rektorit, Sekretari-arkivin dhe çdo pozicion tjetër që lidhet me fushat përshkruar në nenin 66, pia 3 e ligjit të referuar.

- d) Veprimtaria e kategorisë së personelit ndihmësakademik me karakter administrativ ndikon/ndihmon dhe mbështet realizimin e proceseve të përcaktuara në ligj dhe në asnjë rast funksioni i tij nuk duhet të ketë lidhje me: a) realizimin praktik të buxhetit vjetor dhe afatmesëm, b) veprimtarinë financiare të institucionit c) procedura prokurimi, (me përjashtim kur



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

parashikohet në ligj), d) kryerjen e shërbimeve për mirëmbajtjen, meremetimin dhe rikonstruksionin e godinave ku kryhet procesi mësimor.

Kategorizimi i personelit të pozicioneve të mësipërme (pika d) dhe nivelet e pagave të tyre, sipas nenit 67 (Personeli administrativ) të Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", është kompetencë e Bordit të Administrimit. Punësimi dhe vlerësimi i kësaj kategorie, me natyrë rreptësishtë financiare, administrative, mirëmbajtëse e shërbyese, rregullohen në Statut dhe rregulloret e brendshme të UV-së.

3. Vendimi protokollohet dhe bëhen njoftimet përkatëse.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Prof. Dr. Roland ZISI

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Ky dokument përpilohet në 3 (tri) kopje.